



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21, 22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 17, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, si dhe në bazë të kërkesës 05 Nr. 351/05-270912/22 dt. 16.12.2022, të pronarit /investitorit "Arnor Invest, L.L.C."Rr.Ferid Curri, nr.143, Arbëri, për ndryshimin e emrit të pronarit të parcelës kadastrale nr.941-64, ZK. Matičan gjegjësisht poseduesit të lejes ndërtimore Vendimit 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 16.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË AKTIT ADMINISTRATIV "VENDIM-LEJE NDËRTIMORE PËR NDËRTIMIN E NDËRTESES SHUMËBANESORE AFARISTE – LAM."A" DHE "B",
05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022

I. MIRATOHET kërkesa 05 Nr. 351/05-270912/22 dt. 16.12.2022, e aplikuesit Arnor Invest, L.L.C. nga Prishtina, për miratimin e ndryshimit të aktit administrativ, përkatësisht ndryshimin e poseduesit të lejes ndërtimore, në lejen ndërtimore "VENDIM - Leje ndërtimore për ndërtimin e i ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5, 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesit/pronarit "Alwera Invest" shpk, me investitor "Alwera Invest" shpk, me seli në Ferizaj, me numër unik identifikues 811271999, dhe me përfaqësues Arben Hasani nga Ferizaj, sipas kërkesës për leje ndërtimore 05 Nr.035/01-63535/21 dt.07.04.2021, për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5, në kuadër të bllokut urban "A-12", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 941-64 ZK Matičan..

II.Ndryshohet akti administrativ "Vendim për lejimin e ndërtimit 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022", i lëshuar nga kjo Drejtori, në emër të aplikuesit/pronarit "Alwera Invest" shpk, me investitor "Alwera Invest" shpk, me seli në Ferizaj, me numër unik identifikues 811271999, dhe me përfaqësues Arben Hasani nga Ferizaj, sipas kërkesës 05 Nr.035/01-63535/21 dt.07.04.2021, ndërtimi i ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5, në kuadër të bllokut urban "A-12", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 941-64 ZK Matičan.

- Ndryshimi ka të bëjë me ndryshimin e emrit të pronarit dhe investitorit të parcelës kadastrale 941-64 ZK Matičan, në tërë përmbajtjen e aktit administrativ të referuar, dhe atë në vend të emrit "Alwera Invest" shpk, me seli në Ferizaj " shënohet "Arnor Invest, L.L.C."Rr.Ferid Curri, nr.143, Arbëri".

III. Me këtë vendim ndryshohet akti administrativ "VENDIM-Leje ndërtimore për ndërtimin e ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5 me referenc 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

Ar sy e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr. 351/05-270912/22 dt. 16.12.2022, të parashtruar nga "Armor Invest, L.L.C."Rr.Ferid Curri, nr.143, Arbëri, Prishtinë, për ndryshimin e Vendimi 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, sipas të cilit është lejuar ndërtimi i ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të këtij Vendimi.

Bashkë me kërkesë janë prezantuar:

- Vendimi i lejes ndërtimore, 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, i lëshuar nga kjo Drejtori (kopje)
- Kopjen e Planit dhe Certifikatën e njësisë kadastrale me nr. 941-64 ZK Matiçan, në emër të "Armor Invest, L.L.C."Rr.Ferid Curri, nr.143, Arbëri, Prishtinë, dhe me sipërfaqe të parcelës prej 2,107m².
- Aktvendimin i lëshuar nga Agjencia Kadatsrale e Kosovës menr.ref.011-463-2/4746/22, për bartjen e posedimit;

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës administrative, ka konstatuar se me aktin administrativ "Vendim i lejes ndërtimore", 05 NR. 035/01-63535/21 DT. 07.11.2022, kjo drejtori ka lëshuar lejen ndërtimore për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumëbanesore dhe afariste – Lamela "A", me etazhitet -2B+S+P+4 dhe Lamela "B", me etazhitet -B+S+P+5, në kuadër të bllokut urban "A-12", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 941-64 ZK Matiçan

Në ndërkohë, sipas dëshmisë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 941-64 ZK Matiçan, bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale më anë të kërkesës 05 Nr. 351/05-270912/22 dt. 16.12.2022, është ndryshuar pronari i asaj prone, përkatësisht prona ka kaluar nga pronësia në emër të "Alwera Invest" shpk, me seli në Ferizaj" në pronësi të "Armor Invest, L.L.C. Arbëri, Prishtinë".

Andaj, kjo drejtori, duke u bazuar në nenin 8 *Poseduesi i lejes* të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, ku thuhet se, citoj: "Nëse poseduesi i lejes ndërtimore ndryshon gjatë ndërtimit, poseduesi i ri i lejes ndërtimore është i obliguar të njoftojë me shkrim organin kompetent që e ka lëshuar lejen ndërtimore, i cili duhet ta reflektojë ndryshimin në leje ndërtimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh", dhe në nenin 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se mund të bëhet ndryshimi i aktit administrativ "Vendim i leje ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0144503/18 dt. 05.03.2019, në tërë përmbajtjen e tij, sipas përshkrimit në pikën II të këtij vendimi. Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI

Ky Vendim u shtyp në 6 (gjashtë) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Kërkesit/ve; Drejtorisë së Inspektionit; kësaj Drejtorie, në dosje të kësaj lënde, në dosje të lëndës 05 Nr.035/01-63535/21 dt.07.04.2021, dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.


Kopje elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit; Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/05-270912/22 DT. 16.02.2023**

Zyrtari,
Anita Osmani



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Faqe 2 prej 2

Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmi@prishtine@rks-gov.net

